



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 7627 Prot.

Tiranë, më 24.09. 2018

Nr. Identifikimi 707

Vendimi 44

### DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

#### VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Emri i Subjektit:** "Beauty of Albania" sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** L72315011G

**Adresa e selisë:** Rr. "George W. Bush", Pallati nr.25, Kulla 2, Kati 2, Nr.3, Kodi postar 1001, Tiranë

**Personi përgjegjës:** Darien Xhindoli

Për të zhvilluar projektin: "**Shfrytëzim sipërfaqësor i gurit gëlqeror**"

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Zona minerare nr. 349/2, Kaninë, Vlorë.

**Sipërfaqja totale:** 2.48 km<sup>2</sup>

**Lloji Mineralit:** Gur gëlqeror

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*



Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:  
Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:**

- Në raportin e thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të reflektohet legjislacioni në fushën e mbetjeve;
- Të mbahen parasysh kërkesat e nenit 38, ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë";
- Mbetjet inerte që do të gjenerohen të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";
- Mbetjet që do të krijohen të specifikohen sipas kodit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" të ndryshuar;
- Informacion mbi vajrat e përdorura të makinerive, të cilat klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 07.11.2012 "Për rregullat dhe procedurat për asgjësimin e vajrave të përdorur";
- Informacion mbi bateritë e automjeteve, që klasifikohen si mbetje jashtë përdorimit dhe të rrezikshme. Të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 4.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre";
- Subjekti që do të transportojë apo transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licencë të tipit III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar,
- Të respektohen kërkesat e VKM nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore";

Të jepet informacion i zgjeruar në raport, rreth:

- a. sasisë së gjenerimit të mbetjeve,
  - b. trajtimit të mbetjeve;
  - c. transportimit të mbetjeve dhe
  - d. asgjësimit të mbetjeve, sipas kërkesave e akteve të sipërcituar dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;
- Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat;
  - Në raportin e thelluar të VNM-së të reflektohet legjislacioni në fushën e ajrit si: Ligji nr. 10266 datë 15.04.2010 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i cili amendon ligjin nr. 8897 datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" dhe VKM-së nr.435 datë 12.09.2015 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, subjekti duhet të hartojë një plan masash paraprake për të ulur shkarkimet në ajër.
  - Sugjerojmë që të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
  - Raporti i thelluar duhet të strukturohet dhe të përmbajë të gjithë informacionin e kërkuar në shkojcën II të VKM nr. 686/2015.

